

Champions League/ Skënderbeu zgjidh problemin e vizave!

nga AlbaniaSoccer
E hënë, 20 Korrik 2015 01:20



Skuadra kampione e Skenderbeut e ka zgjidhur perfundimisht problemin e vizave. Skuadra Korcare do te udhetoje fillimisht drejt Parisit dhe pritet qe ditën e hene paradite te pajiset me viza qe i lejojnë lojtarët dhe stafin drejtues te hyne ne Irlandën e Veriut.

Pasi te perfundojnë procedurat per pajisjen me viza Britanike ne Paris, skuadra do te udhetoje me carter drejt Belfastit, per tu akomoduar dhe organizuar per takimin e kthimit te turit te dyte eliminator te Champions League ndaj Krusaders.

Ekipi pritet qe te arrije ne qytet ne kohen e duhur per te zhvilluar nje stervitje perfundimtare perpara takimit qe do te luhet ditën e Marte ne Belfast